



QENDRA E TRAJNIMEVE &  
BURIMEVE PËR AVOKIM



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERICKOG NARODA



# THE ADVOCATE

Përkrah Organizatat Jo-qeveritare

Vëllimi VI • Numri 1 • Mars 2008

## PËRMBAJTJA

### Faqe 2

ATRC ngrit kapacitetet e OJQ-ve për t'i shërbyer më mirë komunitetit

Shoqëria civile diskuton strategjinë e sigurisë për Kosovën

### Faqe 3

OJQ "Elena Peshkopia" bind Komunën e Gjilanit tu ndaj bursa studentëve

Komuna e Prishtinës shqyrton draft statutin e saj me OJQ-të

Koalicioni i OJQ-ve "Demokracia në Veprim" publikon raportet e zgjedhjeve

### Faqe 4

Hope Fellowships shpall konkurs për Programin e Kosovës për Udhëheqje

Dialogu Ndëretnik në Kosovë

Udhëzuesi Botëror i Minoriteteve dhe Popujve Vendës

Rr. Tringë Smajli Nr. 21  
Prishtinë, Kosovë. Telefon/Fax:  
+381 (0) 38 244 810

## Diskutimet publike për kushtetutën e re të Kosovës

### "Kushtetuta e Kosovës vendos themelin e një shoqërie demokratike"

Anëtarët e Komisionit Kushtetues informuan qytetarët në secilin qytet të Kosovës për draftin e ri të kushtetutës së vendit të tyre gjatë 42 diskutimeve publike të mbajtura në janar, shkurt dhe mars. Diskutimet, e organizuara nga ATRC, janë ndarë në dy faza për të informuar publikun për procesin e hartimit të kushtetutës dhe vazhduar më pas me diskutimin e përmbajtjes dhe marrë komentet e qytetarëve.

"Qëllimi i Komisionit ka qenë të përgatis një dokument i cili reflekton standartet më të larta ndërkombëtare, mundëson mbrojtjen e

të drejtave të të gjithë kosovarëve dhe përcakton bazën e një shoqërie demokratike të bazuar në sundimin e ligjit. Kontributi i qytetarëve gjatë këtij procesi e ka shtyrë Komisionin më afër përmbushjes së këtij qëllimi", ka deklaruar Hajredin Kuqi, kryesues i Komisionit Kushtetues.

#### Informimi për procesin

Në janar dhe fillim të shkurtit, ATRC-ja ka organizuar takime publike në 19 qytete të të gjitha rajoneve në Kosovë duke i ofruar mundësinë publikut të informohet dhe të ketë qasje në informata të sakta për procesin

kushtetues dhe rëndësinë e tij.

Takimet e fazës së parë informuan çështje kushtetuta, si mbrohen të drejtat e njeriut me kushtetutë, si mbrohen të drejtat e komuniteteve, pse ndarja e kompetencave të qeverisë është e rëndësishme dhe si mund të trajtohet kjo përmes kushtetutës, kujt i referohet "sundimi i ligjit" dhe si mund të inkorporohet në kushtetutë, cili është roli dhe mandati i komisionit kushtetues ...

*Vazhdon në faqen e dytë*



Të rinj në radhë për të shkruar në skulpturën 'New Born' në qendër të Prishtinës e cila simbolizon lindjen e shtetit më të ri në botë më 17 shkurt

Publikimi i këtij buletini mundësohet nga përkrahja zemërgjerë e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e ATRC-së dhe nuk reflekton detyrimisht qëndrimet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

### Shoqëria civile diskuton strategjinë e sigurisë për Kosovën

ATRC në bashkëpunim me Qendrën për Studime të Qeverisjes së Mirë të "London School of Economics - LSE" ka organizuar një takim me aktivistë të shoqërisë civile dhe intelektual të Kosovës më 4 mars me qëllim të zhvillimit të një strategjie të sigurisë për Kosovën bashkarish me anëtarët e grupit studimor për siguri. Ky grup i raporton Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Javier Solanës, për të siguruar që misioni i ri i BE-së në Kosovë bashkë me KFOR-in u japin prioritet sigurimit human dhe merren me çështje të statusit në aspektin e implikimeve të tyre në siguri.

Takimi u përqendrua në këtë strategji për Kosovën dhe shërbeu për të planifikuar mënyrat e implementimit të saj përmes monitorimit të misionit të BE-së, organizimit të konsultimeve ndërmjet shoqërisë civile në Kosovë dhe përfaqësuesve të BE-së, lobimit në Bruksel e më gjerë tek qeveritë evropiane dhe shoqëria civile.

Grupi studimor për siguri përbëhet nga ish komandanti i NATO-së në Kosovë Gjeneral Klaus Reinhardt, ish sekretarja spanjolle e mbrojtjes Narcis Serra, kryesuesi i fraksionit SPD në parlamentin gjerman Gert Weisskirchen, sikurse edhe akademikë të njohur të fushave si ligji ndërkombëtar, mbrojtja dhe të drejtat e njeriut.

*Për më shumë informata, kontaktoni [info@advocacy-center.org](mailto:info@advocacy-center.org);*

## "Kushtetuta e Kosovës vendos themelin e një shoqërie demokratike"

*Vazhdon nga faqja 1*

### Pjesëmarrja e publikut në hartimin e kushtetutës

Pasi Komisioni publikoi draft-kushtetutën më 17 shkurt, shqyrtimi i përmbytjes së saj pasoi në mbarë Kosovën përmes diskutimeve publike në 22 qytete. "Kjo kushtetutë ka tri misione historike. Së pari ajo po e themelon Republikën e Kosovës si shtet të pavarur. Misioni i dytë shtrihet në implementimin e standardeve ndërkombëtare të përcaktuara nga pakaja e Ahtisaarit, dhe së treti kushtetuta shtron rrugën drejtë një shteti funksional në bazuar në republikanizëm dhe ndarje të kompetencave", ka veçuar

më 21 shkurt Arsim Bajrami, anëtar i Komisionit.

Faza e dytë është përqendruar në pjesëmarrjen e publikut në procesin e hartimit të kushtetutës gjatë së cilës shqetësimet e pjesëmarrësve në diskutime janë dëgjuar duke iu dhënë mundësia të komentojnë për çështje të draft kushtetutës. Shqetësimet kryesore të pjesëmarrësve janë fokusuar në sovranitetin e shtetit të Kosovës, zgjedhjen e Presidentit, forcat e ardhshme mbrojtëse,

gjuha zyrtare, definimi i pa-surisë nën-tokësore, çështja e pazgjidhur e kufirit me Maqedoninë, etj. Kopje të draft-kushtetutës u janë shpërndarë pjesëmarrësve në secilin takim publik. *Për të lexuar draft-kushtetutën dhe informata shtesë, vizitoni [www.kushtetutakosoves.info](http://www.kushtetutakosoves.info)*



*Diskutimi publik për kushtetutën e re të Kosovës më 21 shkurt në Prishtinë*

### Programi i trajnimeve

## ATRC ngrit kapacitetet e OJQ-ve për t'i shërbyer më mirë komunitetit

ATRC-ja është aktivisht e angazhuar që përmes programit të trajnimeve t'i ndihmojë përfaqësuesit e organizatave jo-qeveritare për të ndikuar në ndryshime në komunitetet e tyre.

Përmes këtij programi është ofruar trajnim për menaxhim organizate, avokim, punë me media, marketing, planifikim strategjik, menaxhim konflikti, negociata dhe tema të tjera me rëndësi për OJQ-të. Meqë organizatat janë përballur me sfida të reja, ATRC-ja ka modeluar trajnime më të avancuara për ti përmbushur nevojat e tyre.

Gjatë vitit 2007, trajnerët e ATRC-së kanë realizuar 62 trajnime bazike dhe të avancuara në fushat kryesore të zhvillimit organizativ të OJQ-ve, menaxhim, avo-

kim dhe shtim fondesh, në të cilat 1278 pjesëmarrës të gjashtë nacionaliteteve kanë marrë certifikata për pjesëmarrje të suksesshme në trajnime.

"Kam marrë pjesë në disa trajnime të ATRC-së. Kjo më ka mundësuar të marrë njohuri të dobishme për punën time", ka theksuar Sahit Hashani, pjesëmarrës në trajnim.

Që kur ATRC është partnere në implementimin e Programit Kosovar për Shoqëri Civile të kryesuar nga IREX prej vitit 2005, ka dizajnuar dhe mbajtur trajnime për shkrim të projekt propozimit, avokim dhe ndërtim koalicioni, menaxhim bazik të financave, menaxhim të OJQ-së, planifikim strategjik, komunikim, monitorim dhe vlerë-

sim, menaxhim të ciklit të projektit, marketing, qeverisje të mirë, marrëdhënie OJQ-media, analizim të kostos, rolin e OJQ-ve në shoqërinë civile, menaxhim konflikti dhe negociata.

"Do të dëshiroja që trajnimet e ATRC-së të vazhdojnë në të ardhmen pasi që po kontribuojnë në zhvillimin e gjeneratave të reja", ka pohuar Vitjana Kastrati, po ashtu pjesëmarrëse në trajnim.

Trajnimet kanë qenë pa pagesë për OJQ-të kosovare të regjistruara klientë të ATRC-së, që gjithsej janë 226 OJQ.

*Për më shumë informata, kontaktoni [training@advocacy-center.org](mailto:training@advocacy-center.org)*

## Publikime të reja

**"Demokracia në Veprim" publikon raportet e zgjedhjeve**

Koalicioni i OJQ-ve "Demokracia në Veprim: Zgjedhjet 2007" ka prezantuar dy publikime të përgatitura nga Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave në një konferencë të mbajtur më 3 mars në Hotelin Grand, Prishtinë. Publikimi i "Analizë e Zgjedhjeve: Trendet dhe mësimet e nxjerra" dhe "Raporti mbi Monitorimin e Mediave gjatë Fushatës Zgjedhore" ka përmbullur projektin gjashtë-mujor mbi monitorimin e zgjedhjeve në Kosovë nga "Demokracia në Veprim". "Shumica prej raporteve të mediave të monitoruara gjatë fushatës zgjedhore janë përpjekur ti përmbahen kodit gazetaresk të mirësjelljes. Kjo nuk do të thotë se kanë qenë të balancuara në aspektin sasior (kohë/hapësirë) dhënë subjekteve dhe zyrtarëve partiakë", thuhet në Raportin e Monitorimit të Mediave.

Koalicioni i 11 OJQ-ve, të cilat monitoruan zgjedhjet parlamentare dhe lokale të mbajtura më 17 nëntor, ka kryesuar shoqërinë civile në ngritjen e vetëdijes për rëndësinë dhe nevojën e një pjesëmarrjeje të lartë të qytetarëve në zgjedhje.

Dy-mijë e katërqind aktivistë të koalicionit monitoruan procesin zgjedhor, fushatën zgjedhore, mbulimin nga mediat të fushatës së partive politike, kryen numërimin paralel të votave dhe publikuan rezultatet e para. Iniciativa është përkrahur nga ATRC dhe IREX Programi Kosovar për Shoqëri Civile. *Për më shumë informata, vizitoni [www.democracy2007.net](http://www.democracy2007.net)*

**Mundësi shkollimi****OJQ "Elena Peshkopia" bind Komunën e Gjilanit tu ndaj bursa studentëve**

Shumica e qytetarëve të Komunës së Gjilanit janë të rinj të cilëve ju duhet të zhvendosen në kryeqytet ose në ndonjë vend rajonal/të huaj për ti vazhduar studimet universitare. Gjendja ekonomike i detyron shumë prej tyre të ndërprejnë studimin dhe kështu vazhdimin e karrierës. Elena Peshkopia, OJQ lokale, beson se ndarja e bursave një numri të caktuar studentësh nga qeveria lokale do të ishte zgjidhje për këtë çështje në Gjilan. Për këtë arsye, anëtarët e "Elena Peshkopias" për katër muaj janë angazhuar aktivisht në përpjekje avokuese për mundësuara një zgjidhje të tillë.

Fillimisht, ato janë takuar me autoritetet komunale në përpjekje për ti bindur mbi rëndësinë e marrjes së vendimeve në favor të ndarjes së bursave studentëve të Gjilanit. Në nëntor dhe dhjetor 2007, Elena Peshkopia ka organizuar dy debate publike ku morën pjesë përfa-



Debatë në Radio Energy për të promovuar kërkesën e studentëve për bursa

qësues të institucioneve arsimore, organizatave studentore, Rrjetit Rinor të Gjilanit dhe mediave. Debatet kanë pasur për qëllim të bëjnë presion në vendimarrësit lokal për të aprovuar kërkesën e studentëve.

Me qëllim të promovimit të kësaj kërkesë, dy radio debate janë koordinuar nga kjo OJQ të transmetuara në Radio Energy me pjesëmarrje të zyrtarëve komunal, studentëve dhe grupeve të interesit. Radio debatet i ofruan mundësinë publikut të përfshihet dhe shqetësimet e qytetarëve për këtë çështje të dëgjohen

përmes thirrjeve telefonike. "Gjatë implementimit të projektit, Elena Peshkopia ka inicuar një peticion i cili është nënshkruar nga 500 studentë duke kërkuar kështu vendimin i cili do të rregullonte dhënien e bursave në bazë vjetore", ka sqaruar Vjollca Jakupi, menaxhere e projektit. Më pas peticioni i është dërguar Asamblesë Komunale të Gjilanit.

**Rezultatet e arritura**

Avokimi nga Elena Peshkopia ka rezultuar në ndryshim konkret për komunitetin dhe komunën e Gjilanit. Asambleja Komunale në Gjilan ka miratuar një rregullore më 18 shkurt, 2008 e cila përcakton ndarjen e 50 bursave çdo vit për studentë të suksesshëm. Ky institucion tashmë ka shpallur konkurs për aplikim për bursa për këtë vit.

*Për më shumë informata, kontaktoni [vjollcajakupi@hotmail.com](mailto:vjollcajakupi@hotmail.com)*

**Komuna e Prishtinës shqyrton draft statutin e saj me OJQ-të**

Takimi publik për draft-statutin e Komunës së Prishtinës më 6 mars

Përfaqësues të organizatave jo-qeveritare patën rastin të komentojnë dhe diskutojnë draft-statutin e Komunës së Prishtinës gjatë një takimi publik të organizuar nga ATRC-ja më 6 mars në të cilin mo-

rën pjesë Kryetari i Prishtinës Isa Mustafa dhe anëtarët e komisionit për hartimin e statutit. Më 21 shkurt, Asambleja Komunale e Prishtinës ka miratuar draft-statutin për të vazhduar me fazën e diskutimit publik të këtij draftit prej 28 shkurtit deri më 7 mars, me qëllim të informimit dhe marrjes së komenteve nga qytetarët, institucionet qeveritare dhe sektori i shoqërisë civile. Prezantimi i kryetarit Mustafa për OJQ-të

u përqendrua në përmbajtjen dhe procesin e hartimit të këtij dokumenti ligjor. Pjesëmarrësit shprehën shqetësimet e tyre për disa çështje të definuara me këtë dokument siç janë numri i diskutimeve me qytetarë dhe i dëgjimeve publike me fokus grupet para miratimit të draft-rregulloreve, data e ditës së Prishtinës, politika e komunës ndaj peticioneve publike dhe procesi i shqyrtimit të tyre, mandati i këshilltarëve të Asamblesë Komunale, etj.

*Draft-statuti i Komunës së Prishtinës mund të shkargohet në [www.prishtina-komuna.org](http://www.prishtina-komuna.org)*



**Executive Director**  
RREZE DULI  
rreze@advocacy-center.org

**Financial & Administration  
Manager**  
GANI ASLLANI  
gani@advocacy-center.org

**Grant Manager**  
KUSHTRIM KALOSHI  
kushtrimk@advocacy-center.org

**Grant Officer**  
NATYRA ZHJEQI  
natyra@advocacy-center.org

**Grant Finance Manager**  
SAFETA XHEKOVIC  
safeta@advocacy-center.org

**Training & Consultancy  
Services Manager**  
DONIKA SALIHU  
donika@advocacy-center.org

**Trainer & Consultant**  
AFERDITA SURROI  
aferdita@advocacy-center.org

**Trainer & Consultant**  
KUSHTRIM ISLAMI  
kushtrim@advocacy-center.org

**Trainer & Consultant**  
NORA SUSURI  
nora@advocacy-center.org

**Communication & Outreach  
Manager**  
ARJETA DOROCI  
arjeta@advocacy-center.org

**IT and Database Manager**  
ARSIM KOSUMI  
arsim@advocacy-center.org

## Hope Fellowships shpall konkurs për Programin e Kosovës për Udhëheqje

Programi Hope Fellowships i Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan shpall konkurs për aplikim për Programin për Udhëheqje nga të rinjtë e moshës 18-28 vjet, përfaqësuesit e shoqërisë civile, universitetit, institucioneve qeveritare dhe mediave.

Programi ka për qëllim të zhvilloj aftësitë e udhëheqjes dhe kapaciteteve për të krijuar udhëheqje aktiviste në ndihmimin e zhvillimeve demokratike në Kosovë.

Në kuadër të këtij programi ofrohen kurse për mobilizim të komunitetit, marrëdhënie me publikun, metodologjinë e hulumtimit, shtim fondesh dhe planifikim financiar, planifikim strategjik, dhe monitorim dhe evaluim.

Afati i fundit për dorëzim të aplikacioneve është 31 marsi, 2008.

Aplikacionet mund të merren në zyret e Programit Hope Felloëships në Rr. Sejdi Kryeziu, Nr. 5, Qyteza Pejton, Prishtinë, ose të shkarhohen nga ëeb faqja ëëë.naac-hf.org.

*Për më shumë informata, kontaktoni 038 544 293*

### Raport i ri

## Dialogu Ndëretnik në Kosovë

Projekti mbi Marrëdhëniet Etnike ka publikuar raport të ri më 28 shkurt për dialogun politik ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë.

Takimet e liderëve të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës të përfshirë në këtë raport janë mbajtur më 31 janar dhe 1 shkurt, 2008 në Prishtinë të organizuar për të asistuar në definimin e qështjeve në të cilat bash-

këpunimi ndëretnik është i mundur pavarësisht statusit përfundimtar.

Numri i konkluzioneve dhe rekomandimeve të përbashkëta të dala nga dy dialog tregon se shqiptarët dhe serbët e Kosovës janë më realist për të ardhmen e tyre të përbashkët sesa që zakonisht raportohet.

Për raportin e plotë vizitoni: [http://www.per-usa.org/Reports/Political\\_dialogue\\_Ja-](http://www.per-usa.org/Reports/Political_dialogue_Ja-)

[nuary\\_2008.pdf](#)

Burimi: Balkan Academic News



*Për më shumë informata, kontaktoni [per@per-usa.org](mailto:per@per-usa.org)*

### Link i ri

## Udhëzuesi Botëror i Minoriteteve dhe Popujve Vendës

Grupi Ndërkombëtar për të Drejtat e Minoriteteve ka njoftuar më 27 shkurt për lancimin e udhëzuesit të parë online për minoritete dhe popujve vendës në nivel botëror.

Udhëzuesi Botëror i Minoriteteve dhe Popujve Indigjen

jen përfshinë 220 vende dhe terrore të varura, dhe përshkruan 700 minoritete/popuj indigjen.

Udhëzuesi është burim unik për politikëbërësit, qeveritë, gazetarët, akademikët dhe të gjithë të interesuarit në fushën e të drejtave të minoriteteve.

tave të minoriteteve.

Për të pasur qasje në këtë udhëzues, vizitoni

<http://www.minorityrights.org/directory>

*Burimi: Balkan Academic News*



*Grupi Ndërkombëtar për të Drejtat e Minoriteteve punon në mbrojtjen e minoriteteve dhe popujve indigjen*